



SBASHK

Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kultures

Arsimimi

KULTURA E NJERIUT



Ë-buletin

Maj, 2017

Vazhdon të fuqizohet roli i femrës në SBASHK


Gjithnjë e më shumë kolege në pozita udhëheqëse sindikale



SBASHK-u vazhdon të përmbush me përpikëri planin strategjik edhe në fushën e fuqizimit të gruas në sindikatë, pasi që ky vit është vit zgjedhor në gjitha komunat dhe presim që të kemi më shumë femra në pozita udhëheqëse. Me qëllim që të forcohet roli i femrës në sindikatë dhe që ajo të ketë përgatitje solide për t'u përballur me sfidat është zhvilluar një trajnim 3 ditësh me koleget tona nga shumë komuna e që janë zgjedhur . Në ditën e parë të këtij ... (faqe 4)

SBASHK nënshkruan marrëveshje me Spitalin Amerikan

Zbritje çmimesh për anëtarësinë në këtë institucion të njohur shëndetësor



Të gjithë anëtarët e Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kultures (SBASHK) nga kjo(faqe 5)

Përgatitje e vazhdueshme për dialogun social

SBASHK organizon trajnime për të zgjedhurit e ri

Ka kohë që kanë nisur zgjedhjet nëpër shoqata sindikale të shkollave dhe në njësi(faqe 8)

Intervistë me mësimdhënësen dhe sindikalisten Pranvera Haziri

Të rinjtë gjithnjë e më të pranishëm në angazhimet dhe aktivitetet e SBASHK-ut

Pranvera është krenare që udhëheq shoqatën sindikale të shkollës së saj. Ajo ka përfunduar ... (faqe 3)

SBASHK-u mori pjesë në konferencën e ETUCE-së në Bruksel

'Arsimi në Evropë: Investimet Publike, Privatizimi dhe Reformat - Çfarë roli luajnë sindikatat e arsimit?'



Më 30 maj 2017 në Bruksel, SBASHK-u mori pjesë në një konferencë të Komitetit Evropian ... (faqe 6)



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kultures
The Union of Education, Science and Culture

Editorial

Zgjedhjet



Rastësi, por ja që ndodhi. Viti 2017 u bë vit i zgjedhjeve. SBASHK-u me kohë kishte planifikuar që ky vit të jetë i zgjedhjeve duke filluar nga shoqatat sindikale e për të vazhduar pastaj edhe me nivelet e arsimit fillor, të mesëm e në universitet. Zgjedhjet në SBASHK po shkojnë sipas dinamikës së paraparë dhenë shumë shoqata po sjellin kuadro të reja udhëheqëse e që është një moment i mirë dhe dëshmi se sindikata jonë ka unitet dhe gëzon respekt kudo në institucionet arsimore.

Zgjedhje ka edhe në Kosovë për Parlamentin dhe Qeverinë. Urojmë që fushata të kalojë në atmosferë të një gare korrekt e në frymën

demokratike. SBASHK pret që këto zgjedhje të jenë të suksesshme dhe të japin pa u vonuar organet qeveritare me të cilat sindikata jonë do të nis pa humbur as edhe një minutë dialogun për të qar përpara punët që mbeten pa u përfunduar.

Anëtarësia jonë e di se SBASHK-u është sindikatë apolitike dhe ka respektuar e respekton organet shtetërore që dalin nga vullneti i popullit i shprehur me votën e tyre. SBASHK-u, po ashtu kujton opinionin se i jep rëndësi e hapësirë të madhe zgjedhjes së çështjeve të ngritura e kërkesave të anëtarësisë me dialog, por pavarësisht se cilat subjekte janë duke qeverisur shtetin, SBASHK-u kur nuk ec dialogu bëjnë edhe veprime sindikale . Kështu do të jetë edhe në të ardhmen.

Për çdo pyetje, sugjerim apo informata shtesë , mund të vizitoni ueb-faqen tonë:

www.sbashk-rks.org

Mos hezitoni të na jepni sygjerrime për përfshirjen edhe të ndonji rubrike në interes të anëtarësisë në gazeten e juaj elektronike Arsimi sot.

Që SBASHK-u të jetë gjithnjë në shërbim të anëtarësisë, së shpejti do të ofroj shërbime këshillimi për ngritje profesionale për anëtarët e vet si dhe së shpejti do të paraqiten video-spote në ueb-faqen e SBASHK-ut rreth shërbimeve për anëtarësinë.

Botues: Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës(SBASHK) përfaqëson rreth 20.500 anëtarë në gjithë sektorët e arsimit në Kosovë, duke përfshirë edhe komunitetet. SBASHK është anëtare e **Edukimit Internacional (EI)** që nga viti 1996.

Email: info@sbashk-rks.org

Tel. +381(0)38/ 226 940



Intervista

Intervistë me mësime dhe sindikalisten Pranvera Haziri

Të rinjtë gjithnjë e më të pranishëm në angazhimet dhe aktivitetet e SBASHK-ut



Pranvera është krenare që udhëheq shoqatën sindikale të shkollës së saj. Ajo ka përfunduar studimet post diplomime për gjuhë shqipe dhe letërsi, por është në përfundim edhe të fakultetit të edukimit në programin fillor. "Me të vërtetë është nder dhe privilegj të kesh titullin "mësuese" dhe të jesh

pjesë e një grupi mësime dhe sindikalisten siç është ai i shkollës sonë. Një fole e diturisë e stolitur aq bukur me dashuri dhe respekt për njëri – tjetrin", shprehet ajo në intervistën për gazetën tonë, për të bërë edhe apel drejtuar organeve udhëheqëse të SBASHK-ut: "Ju lutem mos u ndaloni por vazhdoni po me këtë temp në realizim të kësaj të anëtarësisë sepse keni besimin e tyre". Pranvera lavdëron angazhimet dhe arritjet e kryetares së Kuvendit të SAF e SAM të Mitrovicës, Vjollca Shala.

Arsimimi Sot:

1. Kush është Pranvera?

Pranvera:

Po e filloj këtë shkrim me përshëndetjet për ju mësime dhe për ju anëtarë të SBASHK-ut! Pranvera Haziri, është e lindur me 25 Mars 1991, në Mitrovicë. Pranvera, ka mbaruar studimet post diplomike (master) në Fakultetin e Filologjisë "Hasan Prishtina" departamenti Gjuhë Shqipe - Prishtinë, po ashtu t jam edhe studente e Fakultetit të Edukimit programi Fillor "Isa Boletini" në Mitrovicë.

Tani për mua është viti i katërt si mësuese në shkollën fillore "Sefedin Smakolli" në fshatin Rashan. Me të vërtetë është nder dhe privilegj të kesh titullin "mësuese" dhe të jesh pjesë e një grupi mësime dhe sindikalisten siç është ai i shkollës sonë. Një fole e diturisë e stolitur aq bukur me dashuri dhe respekt për njëri - tjetrin. Siç e dimë të gjithë ne, se sfidat e punës në arsim janë shumë të mëdha, duke parë kushtet e punës me të cilat ballafaqohemi, dhe vendin e varfër, por të gjitha këto harrohen dhe

tejkalohehen kur shohim rezultatet e shkëlqyera të nxënësve tanë...

Arsimimi Sot:

2. Ku informoheni për punën dhe aktivitetet e SBASHK-ut?

Pranvera:

Për punën dhe aktivitetet e SBASHK-ut vlen të theksohet në radhë të parë se kemi një bashkëpunim të mrekullueshëm me përfaqësuesit e shkollave, ku ky bashkëpunim vazhdon të rrjedhë falë kryetares (profesoreshës) Vjollcës, e cila gjithmonë është aq e palodhshme, aq e pa printueshme për ne me të gjitha ato pyetje e kërkesa që ne i drejtohem asaj. Pra, pikërisht është Vjollca, ajo që na lajmëron, na njofton për çdo gjë rreth sindikatës, po ashtu duke mos harruar edhe rrjetin social, ku aty i kemi të paraqitura të gjitha punët dhe aktivitetet e SBASHK-ut.

Arsimimi Sot:

3. Çfarë e shtyri shkollën tuaj të anëtarësohet në SBASHK?

Pranvera:

Ideja për tu bashkuar edhe shkolla jonë në SBASHK që krejt e pa pritshme dhe spontane. Gjatë vitit të kaluar tetor-nëntor kolektivi ynë gjatë mbartjes së një mbledhje diskutuam për punën që është duke bërë SBASHK-u, për rezultatet e arritura të asaj periudhe. Kështu aty për aty vendosëm që edhe ne si shkollë të bëhemi pjesë e kësaj sindikate. Falë respektit të kolegëve ndaj meje, si dhe vlen të përmendet mbështetja e drejtorit të shkollës sonë i cili që ai që realizoi takimin tim me kryetaren e sindikatës sonë në nivel komunal profesoreshës Vjollca Shala, dhe pikërisht ishte ajo që falë mikpritjes më bindi 100% dhe sot vazhdojmë të jemi edhe ne pjesë e SBASHK-ut.

Arsimimi Sot:

4. Çfarë pozite në sindikatë keni?

Pranvera:

Edhe pse jam unë ajo më e reja e grupit të mësime dhe sindikalisten të shkollës sonë, falë respektit

dhe besimit nga ana e tyre, sot gëzoj pozitën e kryetares- përfaqësueses së shkollës sonë" Sefedin Smakolli" - Rashan.

Arsimimi Sot:

5. Sa është përfshirja e të rinjve dhe femrave në arsim në komunën tuaj?

Pranvera:

Sa i përket përfshirjes së të rinjve dhe femrave në komunën tonë të Mitrovicës, e sidomos në këto tri vitet e fundit është mjaftë e kënaqshme ngase me të vërtetë komuna jonë ka një numër bukur të madh të mësimitdhënësve të moshës së re dhe patjetër që është prezent gjinia femërore ku këtë e dëshmoj edhe unë si mësimitdhënëse e re në moshë dhe me pozitë vendimarrëse.

Arsimimi Sot:

6. Cilat trajnime do t'ia propozonit SBASHK-ut për anëtarësinë e vet?

Pranvera:

Sa i përket trajnimeve, edhe pse e re e anëtarësuar pata rastin të jem pjesë e trajnimit " Dialogu Social" ku me të vërtetë vlen të theksohet puna e palodhshme e profesorit Ymer Ymerit dhe e kryetarit Rrahman Jasharaj, që me njohuritë e tyre e elaburuan aq bukur këtë temë aq të ndjeshme për komunitetin tonë. Trajnime të tjera që unë mendoj që do të ishin të mirëpritura edhe nga të tjerët janë pikërisht ato trajnime për përfundimin e rolit të femrës në pozita

vendimarrëse (po tregohem pak feministe) e jo që gjithmonë të jetë vetëm gjinia mashkullore, më pas trajnime për të drejtat e mësimitdhënësve në rast ballafaqimi me probleme të natyrave të ndryshme.

Arsimimi Sot:

7. Çfarë do të veçonit për të mirë në SBASHK?

Pranvera:

Në radhë të parë vlen të ceket një e vërtetë që ekziston e cila është ajo që një grup aq i madh i mësimitdhënësve janë dhe vazhdojnë të mbeten të mbledhur vetëm e vetëm në një sindikatë SBASHK-u e jo shumë sosh. Kjo edhe është për tu lavdëruar! SBASHK-u është ajo sindikatë që gjithnjë dita - ditës po punon dhe po "lufton" për të drejtat tona si mësimitdhënës përkundër vështirësive e që ne i hasim pothuajse në çdo derë që ne trokasim....

Arsimimi Sot:

8. A keni diçka për të shtuar?

Pranvera:

Së pari me lejoni të ju falënderoj juve për këtë intervistë. Ju uroj shëndet dhe suksese të mëtutjeshme! Kurse sa i përket sindikatës ju lutem mos u ndaloni por vazhdoni po me këtë temp, le të jemi ne ata vendimarrës për obligimet dhe detyrat tona që na takojnë!

Gjatë muajit

Vazhdon të fuqizohet roli i femrës në SBASHK

Gjithnjë e më shumë kolege në pozita udhëheqëse sindikale



SBASHK-u vazhdon të përmbush me përpikëri planin strategjik edhe në fushën e fuqizimit të gruas në sindikatë, pasi që ky vit është vit zgjedhor në gjitha

komunat dhe presim që të kemi më shumë femra në pozita udhëheqëse. Me qëllim që të forcohet roli i femrës në sindikatë dhe që ajo të ketë përgatitje solide për t'u përballur me sfidat është zhvilluar një trajnim 3 ditësh me koleget tona nga shumë komuna e që janë zgjedhur

Në ditën e parë të këtij trajnimi, trajnerja Vjollca Shala ka shpalosur fillimisht çështje që lidhen me rolin dhe fuqizimin e femrës në SBASHK dhe përfshirjen e tyre në pozita udhëheqëse.

Rëndësi të veçantë i është kushtuar qasjes së femrave

në pozita udhëheqëse si në shkollë ashtu edhe në sindikatë.



I tërë aktiviteti po zhvillohet në formë të bashkëbisedës dhe pjesëmarrëset janë pajtuar se këtë përvojë do t'a përcjellin edhe tek koleget e tyre.

Gjatë ditës së dytë, u zhvilluan tema me rëndësi lidhur me dialogun social, ku trajneri i licencuar Ymer Ymeri, fillimisht hapi çështjet që janë me interes të

veçantë sa i përket dialogut si në shkollë ashtu edhe në nivel komunal.

Trajnimi do të zgjasë deri të dielën, ku pjesëmarrëset do të ndjekin edhe trajnimin mbi forcimin e kapaciteteve të dialogut social dhe do të shpalosen



edhe tema e çështje të tjera me rëndësi sa i përket si fuqizimit të femrës ashtu edhe dialogut social, të cilat ndihmojnë në forcimin e kapaciteteve për udhëheqje efektive të dialogut social dhe përfshirjen e femrave në pozita udhëheqëse.

SBASHK nënshkruan marrëveshje me Spitalin Amerikan

Zbritje çmimesh për anëtarësinë në këtë institucion të njohur shëndetësor

Të gjithë anëtarët e Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK) nga kjo marrëveshje përfitojnë ulje 20% në diagnostikë dhe 15% ulje në ndërhyrje kirurgjikale, ndërsa për familjaret e anëtarëve të SBASHK-të vlen ulja 20% në diagnostikë . Kjo është thelbi i përmbajtjes së



Marrëveshjes së nënshkruar nga Dr. Nevrus Çaushaj në merr të Spitalit Amerikan dhe kryetarit të SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj .

“Edhe pse sot po nënshkruajnë një marrëveshje me disa ulje të caktuara, kjo nuk do të thotë që këto do të jenë kështu 100% respektive pasi që Spitali Amerikan po të ketë mundësi që të bëjë lëshime akoma dhe më shumë edhe mbi këto ulje”, është shprehur në ceremoninë e rastit e para medieve, përgjegjësi i këtij institucioni të njohur shëndetësor, Dr. Çaushaj, i cili pastaj ka shtuar se ata po bëjnë këto veprim human edhe duke parë gjenden aktuale dhe mungesën e sigurimit shëndetësor .

” Spitali ynë është dhe do të mbetet gjithmonë pranë njerëzve që kanë nevojë dhe prandaj duke u nisur nga ky mision mendova që Sindikatës së Bashkuar të

Arsimit, Shkencës dhe Kulturës t'i bëjmë një ofertë të mirë aq sa është edhe mundësia me qëllim që të lehtësojmë aq sa kemi mundësi të gjitha vuajtjet e një kategorie shumë të gjerë dhe të rëndësishme të



shoqërisë civile që ka nevojë për një mbulesë të tillë”, ka shtuar Dr. Çaushaj dhe pastaj bashkë me kryetarin e SBASHK-ut kanë nënshkruar marrëveshjen.

SBASHK-u mori pjesë në konferencën e ETUCE-së në Bruksel

'Arsimi në Evropë: Investimet Publike, Privatizimi dhe Reformat - Çfarë roli luajnë sindikatat e arsimit?'

Më 30 maj 2017 në Bruksel, SBASHK-u mori pjesë në një konferencë të Komitetit Evropian të Sindikatave të Arsimit (ETUCE) me titull: *'Arsimi në Evropë: Investimet Publike, Privatizimi dhe Reformat - Çfarë roli luajnë sindikatat e arsimit?'*.



Konferencën e hapi drejtorja evropiane e ETUCE-së, znj. Susan Flocken, e cila theksoi se kjo ngjarje njëditore shënon kulmin e projektit të investuar në ETUCE "Investimi në arsim: Forcimi i përfshirjes së

“Për ne është një nderë i madh kjo që po e bëni për ne , shpresoj që sa më pak te kemi nevojë për mjek, por ata që kanë nevojë do ta kenë edhe një mundësi të mirë shtesë, një ulje goxha të madhe që Spitali më me emër ofron për ne. Ne këtë e konsiderojmë si respekt që ju keni ndaj mësimdhënësve të Kosovës dhe këtë respekt do ta kthejmë me korrektësi dhe me respektin tonë ndaj jush”, Ka deklaruar Jasharaj .

Marrëveshja ka hyrë në fuqi në ditën e nënshkrimit dhe SBASHK-u in formon anëtarësinë se në rast se kanë nevojë për shërbimet në këtë Spital të njohur me të paraqitur në ambientet e tij te personat zyrtarë të tregojnë kartelën e anëtarësisë dhe një dokument të identifikimit.

SBASHK-u ju uron shëndet të mirë gjithë të punësuarve në arsim . Urojmë që të keni sa më pak nevojë për mjekun, por jeta është e tillë dhe ka sfidat e saj.

sindikatave të mësuesve në semestrin evropian mbi arsimin dhe trajnimin", që u realizua nga viti 2015 deri në vitin 2017.

Ajo deklaroi se "kjo konferencë organizohet vetëm disa ditë pas publikimit të Rekomandimeve Specifike të Vendit të Komisionit Evropian, të cilat paraqesin një fazë kyçe në Semestrin Evropian. Kjo dukuri në kohë e bën kontekstin veçanërisht të përshtatshëm për debatet konstruktive dhe reflektimet mbi gjendjen aktuale të investimeve publike, modelet e privatizimit dhe reformat, si dhe strategjitë për sindikatat e arsimit për t'u angazhuar në dialogun social mbi politikat e reja, pikërisht aty ku nevojitet të bëhet, nëse zëri profesional i mësuesve duhet të futet në hartimin e politikave dhe të kontribuojë në ndërtimin e ardhmërisë së gjeneratave të reja ".

Në këtë konferencë, morën pjesë rreth njëqind pjesëmarrës nga organizatat anëtare të ETUCE nga e

gjithë Evropa, në mesin e tyre edhe SBASHK, partnerët socialë, Komisioni Evropian, si dhe aktorë të tjerë.



Në përputhje me angazhimet dhe vendimet e marra nga Konferenca e ETUCE 2016, në këtë konferencë synim ishte ndarja e praktikave efektive mbi përfshirjen aktive të sindikatave të arsimit në Semestrin European mbi arsimin dhe trajnimin. Kjo për arsye të avokimit për financim afatgjatë të mjaftueshëm, të parashikueshëm dhe të barabartë të arsimit dhe për të mbrojtur sistemet arsimore publike kundër efekteve të dëmshme të politikave buxhetore dhe reformave në të gjithë Evropën.

Kjo konferencë ishte gjithashtu një rast për të zbuluar rezultatet e një hulumtimi të rëndësishëm të ETUCE "Politikat e Arsimit dhe Trajnimit në Semestrin European. Investimet Publike, Politikat Publike, Dialogu Social dhe Modelet e Privatizimit në Evropë", i drejtuar nga Universiteti i Nottingham, lidhur me identifikimin e efekteve të Semestrin European mbi reformat e arsimit në nivel kombëtar dhe modelet e privatizimit në arsim në të gjithë Evropën. Ky hulumtim i paraqitur nga hulumtuesi kryesor, Prof. Hoëard Stevenson, zbulon se deri në ç'masë ideologjia dhe qasjet e orientuara nga tregu dhe biznesi në arsim, të kombinuara me rregulla strikte buxhetore dhe financiare brenda BE-së, po çojnë në komodifikimin, privatizimin dhe marketizimin në arsim dhe për arsim. Rezultatet e këtij hulumtimi do të jenë pjesë në Planin

Strategjik Plotësues të ETUCE për reagimin Global të EI-së ndaj Komercializimit dhe Privatizimit në Arsim. Duke komentuar mbi raportin, drejtorja evropiane e ETUCE-së znj. Flocken tha "hulumtimi zbulon një shkallë më të lartë të privatizimit të brendshëm në arsim në të gjithë Evropën. Ne, edukatorët, kemi një përgjegjësi për të kundërshtuar këtë prirje dhe për të mbrojtur vlerën e arsimit përtej interesave ekonomike dhe ideologjisë së drejtuar nga tregu".



Organizuar në katër sesione tematike, duke filluar nga 1) efektet e semestrin evropian dhe bashkëpunimit evropian për reformat kombëtare të sistemeve të arsimit dhe trajnimit, 2) roli i sindikatave të arsimit në hartimin e politikave, 3) modelet e investimeve arsimore në të gjithë Evropën dhe 4) Nevoja për të zhvilluar një dialog të fuqishëm social për të ribalancuar prioritetet ekonomike dhe sociale, konferenca mbështeti drejtpërdrejt punën e ardhshme të sindikatave të arsimit në nivel evropian dhe kombëtar në fushën e financimit të arsimit dhe hartimit të politikave. Ajo shërben gjithashtu si një mjet për rritjen e njohurive për të përgatitur dialogun social kombëtar në arsim në kuadër të semestrin evropian. Për të maksimizuar mundësitë kombëtare për të ndikuar në semestrin e arsimit dhe trajnimit, organizatat anëtare të ETUCE-së gjithashtu u pajisen me Udhëzuesin Praktik, si rezultat i rëndësishëm i projektit.

(artikull i marrur nga ETUCE)

Përgatitje e vazhdueshme për dialogun social

SBASHK organizon trajnime për të zgjedhurit e ri

Ka kohë që kanë nisur zgjedhjet nëpër shoqata sindikale të shkollave dhe në njësi akademike. Respekti dhe besimi i madh që SBASHK-u falë angazhimeve dhe përkushtimit ka krijuar te anëtarësia ka bërë që zgjedhjet të jenë të nivelit të lartë demokratik dhe të sjellin edhe kuadro të reja që në 4 vitet e ardhme do të jenë zë i anëtarësisë në 1137 institucionet arsimore të Kosovës.



Këto kuadro do të përgatiten për të qenë sa më të suksesshëm në dialogun social me zyrtarë të shkollave, por edhe me përfaqësues të qeverive lokale. Për këtë po vazhdohet me organizimin trajnimeve për forcimin e kapaciteteve për udhëheqje efektive të dialogut social. Në këtë aktivitet kanë marrë pjesë të zgjedhurit e ri nga shkollat e Prishtinës, Podujevës, Gjakovës, Klinë dhe Drenasit.

Trajnerët e licencuar për dialogun social, Ymer Ymeri dhe Safet Beqiri u kanë treguar pjesëmarrësve për përkufizimin e dialogut social. Ata kanë shpjeguar edhe për sfidat që dalin gjatë dialogut social, duke u nisur nga shkolla, niveli komunal e deri te niveli qendror.



E veçanta e këtij i aktivitetet është se seminari zhvillohet të bashkëbisedës dhe prandaj të gjithë bëhen pjesëmarrës aktivë.

Pjesëmarrësit në tri ditët e seminarit janë ndalur në temat kryesore: "Funksionet dhe sfidat e dialogut social",

"Dialogu social në Evropë", "Pyetjet kryesore që shtrohen te dialogu social". Pjesë shumë e rëndësishme e seminareve të tilla është dëshmia praktike e arritjes së njohurive. Disa nga pjesëmarrësit gjenden para një sfide e problemi të caktuar në rolin e sindikalitistit e pjesa tjetër në rolin e punëdhënësit dhe zhvilloj në dialog, i cili edhe pse është në formë të improvizuar, vërehet se



ka plot momente përplasjesh verbale dhe se nuk arrihet edhe lehtë deri të zgjidhja e çështjes së ngritur. Pas njohurive të dëshmuara pjesëmarrësit marrin certifikata të nënshkruar nga trajnerët e licencuar dhe nga MASHT.

Vazhdohet me traditën e mirë

SBASHK-u dërgon 420 anëtarë nga e tërë Kosova në bregdetin shqiptar

Duke vlerësuar e çmuar lart përkushtimin e punëtorëve të arsimit të Kosovës në edukimin e arsimimin e brezave, SBASHK-u vazhdon me traditën e mirë të njohjes së këtij kontributi duke dërguar çdo verë një numër të konsiderueshëm të anëtarëve të vet për pushime në bregdetin shqiptar.



U nis ky aktivitet para 4 vitesh dhe ishin 100 pushuesit e parë nga e tërë Kosova që në mënyrë të organizuar po kalonin bukur pushimet në bregdetin shqiptar. Kjo traditë e mirë vazhdoi dhe numri i pushuesve nga viti në vit shtohet sepse SBASHK-u falë angazhimeve e arritjeve të shumta është bërë sindikata më e fortë dhe më e organizuar në Kosovë.

Numri i anëtarëve të sindikatës sonë për çdo ditë, javë e muaj është në rritje të vazhdueshme.

Në verën 2017 Këshilli Drejtues i SBASHK-ut, pasi ka analizuar në përpikëri mundësitë buxhetore ka vendosur që në çdo 52 anëtarë të dërgojë një pushues në bregdetin shqiptar. Kryesia dhe stafi në tërësi e kanë marrë shumë seriozisht këtë aktivitet sepse ata e dinë se është veprimtari e gjerë dhe me numër të madh pjesëmarrësish. Kështu me kohë janë dërguar formularët nëpër komuna e Universitetet për të bërë ndarjen sipas kritereve të qarta të shkollave e njësive akademike që do të dërgojnë pushues dhe janë mbajtur takimet gjegjëse për të kryer këtë obligim. Pas kësaj shkollat dhe njësitë akademike janë ato që në takimet e tyre në mënyrë transparente e duke i vënë shënimet në formularin unik vendosin se kush do të kënaqet këtë vit me valët dhe atmosferën relaksuese në bregdetin e bukur shqiptar.

SBASHK-u në qendër për ta ruajtur besimin e madh që ka krijuar të anëtarësia dhe për hir të trasparencës së plotë sapo të kryejnë punën e tyre teknike komisionet gjegjëse të formuara nga Kryesia lidhur me çështjet konkrete që lidhen me këtë aktivitet, do të botojë në ueb faqen e saj (sbashk-rks.org) listën e plotë me të gjithë emrat e pushuesve, që janë caktuar nga shkollat dhe njësitë akademike.